

VENDIM
Nr.893, datë 21.12.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.627, DATË 31.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË, PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E
TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.627, datë 31.8.2011, të ndryshuar të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011 - 2012, të jenë 9531, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 8650; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë | 40; |
| c) Kuotat për transferim studimesh | 200; |
| ç) Kuotat për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 400; |
| d) Kuota për personat që nuk shikojnë | 20; |
| dh) Kuota për romët/ballkano - egjiptianë | 20; |
| e) Kuota për të përndjekurit politikë | 201.”. |

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas kolonës D të tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Rishpërndarja e kuotave të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të përcaktuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

Kuotat e çdo programi studimi ndahen në raportin 4:1, përkatësisht 80% e tyre, për pranimet e reja në programe studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe 20% për pranimet e reja në programe të dyta studimi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha